



AMEDEO BAÇI DHE

RISIA E REALIZMIT ROMANTIK

PROF. DOKT. KLARA KODRA
EDONA PALOKA

... ME KONTRIBUTE MONUMENTALE NË FUSHËN E STUDIMIT TË LETËRSË PËR FËMIJË E TË RINJ

Prof.As.Dr. Shpëtim Çausi

- Përmbledhja "Kacafytja me ujkun" e Astrit Bishqemit, në një ceremoni të organizuar në Prishtinë më 7 dhjetor, u nderua libri më i mirë për fëmijë i vitit në Kosovë

Enes Karić

Poema Ëndrra e Muhammedit në shkretëtirë e fisnikes Karoline von Günderrode

Nga gjuha boshnjake përktheu.
Azmir & Behrim JUSUFI, Prizren

ÇMIMET

"OBELISK"

2018

Në brendësi:

- Kthim në origjinë
nga Robert Shkurti

POEZI

- Irma KURTI
- Agron SHELE
- Konstandin DHAMO

- Epigrame
nga DENILU

- Tregim
Kishim vepruar drejt
nga Viron KONA

Enes Karić

Poema

Ëndrra e Muhammedit në shkretëtirë e fisnikes Karoline von Günderrode

Karolina von Günderrode
Karoline von Günderrode
(1780-1806)

Ëndrra e Muhammedit në shkretëtirë

Në mesditën përvëluese,
Ku rërat e shkretëtirës,
Asnjë erë flladi nuk lëshojnë,
Ku valën vetëm samumi puth,
Shkëmbi gri rretë përshëndet,
Aty shikuesi i lodhur zhytet.

Prej iluzionit mashtruese,
Shpirti i tij mban shpresë,
Që esencën e gjërave, me të shikuarit këtu,
do t'i dallojë,
Shpirtin e ardhmërisë ai dëshiron ta thërras,
Zërin e zemrës së vetë ta dëgjojë,
Dhe frymëzimin e saj ta pasojë.

Këtu hyjnia iku,
E cila iluzionin ja flakëroi,
Shkreptirë e kotë u zhduk,
Dhe atë, në të cilën popujt shikuan,
Vetëm palmat fitoret befasojnë,
Bregat e natës së errët rrethojnë.

Ëndrra e shikuesit,
Ditën kapërcen,
Dhe çdo kohë të ardhmen,
Së shpejti, në kllapën dehëse, shijon,
Lumturinë e planeve mahnitëse,
Atëherë ai perëndimin e vetë shikon.

Shtangia dhe trishtimi,
Me valë jo të përhershme,
Në thellësinë e shpirtit luftojnë,
I rrethuar vetëm nga dëshpërimi, ai thërret!
Vendosi ta braktis jetën e vetë tokësore!
Përpara se ta dënojë pendimi dhe mossuksesi.

Fuqi hyjnore,
Shpërndau netët,
Fatet, përpara syve të mi!
Le t' më lëshojë të shoh ardhmërinë,

A valojnë fitimshëm flamujt e mi?
A qeverisë ligji im botën?

Ai atë shqiptoi, u dridh,
Toka atëherë, çohet,
Deti deri nën rretë,
Flakët me shpatet u shtillen,
Ajri me erërat e sqfurit u mbush,
Krahët e lodhura lëshojnë, le të qetësohen.

Në vallen e egër,
Yjet dridhen,
Në kurorë (lulesh) të çmendur duke rrethuar qiellin,
Deti rënkon në thellësitë e veta,
E në krateret më të thella të Tokës,
Grinden fillesat thelbësore.

Dhe lidhje të afërta,
Të cilat janë të shumta,
Lidhja e forcës, duket, lëshoi pe,
Nga ajri del vello e rreve,
Dhe prej humnerës ngrihet zjarri,
Dhe gjithçka tokësore gëlltiti.

Me baticën mashtruese,
Së pari u ndez zjarri me te,
Por ajo nxitet gjithnjë më qartë,
Derisa prej saj tufë rrezesh drite s'ngritet,
E cila flakërimthi deri te yjet arrin,
Dhe e pastër, e ndritur, flakërueshëm vlon.

Shikuesi u zgjua,
Sikurse ec në natën e errët,
Dhe për habi ndihet i gjallë,
I zgjuar prej vdekjes së tmerreve,
Me ngurrim pret, tani,
Zoti gjerdanin e qenies a do ta zgjojë.

Prej yjeve teposhtë,
Shikuesit më afër,
Jehon tani një zë: "Këtu qartë pe ti,
Ç' do të ngjajë me të gjitha gjërat,
Këtu historinë e botës, ti pe.

Atë fuqia e lëvizë,
Ajo krijon dhe rrotullon,
Në shiun e pandalshëm;
Ç' është e papastër, ajo do të zhduket,
Vetëm ajo e pastër, drita mbetet,
Dhe me dritën e përjetshme pajtohet."

Tani nata zhytet dhe zhduket,
Dhe vetëtimthi po zditet,
Agimi në shpirtin e tij,
Asgjë! thërret ai, nuk mund të më,
fitojë më:
Që dritë vetëm të jetë!
Nëse do të jetë lufta ime,
Atëherë, pavdekshëm do të jetë munda im.

Ëndrra e Muhammedit në shkretëtirë e fisnikes Karoline von Günderrode



1
Fisnikja Karoline von Günderrode jetë e shkurt dhe tragjike

Sipas burimeve² të cilat na u janë në dispozicion, fisnikja, shkrimtarja, poetja dhe autorja filozofike Karoline von Günderrode (1780-1806) ishte më e vjetra prej gjashtë vëllezërve dhe motrave. Vjen me prejardhje nga familja aristokrate, por e cila nuk ishte e pasur. Në vitin 1797, rrethanat e saja jetësore zhvilloheshin ashtu që Karoline von Günderrode hyri në një manastir protestant në Frankfurt në Majn. Manastirin e drejtonte fondacioni humanitar, kurse qëllimi i këtij domi ose akomodimi të manastirit ishte krejtësisht specifik: gjegjësisht aty kanë jetuar dhe banuar fisniket e varfra dhe të pamartuara, të

cilat kishin mundësi që të jetojnë këndshëm dhe, nëse u ofrohet mundësia e mirë për martesë, edhe të martohen.

Si rrjedh në kohë qëndrimi i saj në këtë konvikt protestant, në vitet pas Revolucionit Borgjez Francez (1789), kjo shihet në veprat e saja, (ajo) sheh një lloj dëshire "revolucionare" për ta kapërcyer spontanitetin tradicional (sidomos atij të imponuar grave), që të ec në botët e panjohura të cilat janë zbuluar gjithashtu edhe me lëvizjen e romantizmit në Evropë. Shumë pretendojnë se ky është qëllimi që ajo në veprat e veta letrare (p.sh. në dramën historike: "Mahomed, der Prophet von Mekka "Muhammedi, profeti prej Mekës") sjell, si edhe numër i madh i romantikëve të asaj kohe, botëve dhe personaliteteve të famshme jashtë Evropës. Përveç dramës historike "Mahomed, der Prophet von Mekka", janë të njohura edhe veprat "Hildgund" pastaj "Piedro", "Udohla", "Die Pilger" (Pelegrinët), etj.

Natyrisht, numri i madh dhe jashtëzakonisht i vlefshëm i arritjeve tjera poetike të Karoline von Günderrode është pjesë e veçantë në trashëgiminë e saj të shkruar të përmbledhur (për këtë veçanërisht duhet konsultuar p.sh. *Gesammelte Dichtungen* si dhe *Gesammelte Werke der Karoline von Günderrode*) në tri fletoret gjithëpërfshirëse³ në veprat e saja poetike vend të theksuar zë kënga Mahomets Traum in der Wüste ("Ëndrra e Muhammedit në shkretëtirë"),⁴ e cila faktikisht është edhe arsyeja kryesore e shkrimit të esesë sonë.

Karoline von Günderrode dallohej si jashtëzakonisht e talentuar dhe person temperament, shumë ka lexuar, mësuar dhe shkruar. Gjithashtu, korrespondenca e saj me miqtë besueshëm dhe papërzier reflekton shqetësimet dhe emocionet e saja të fuqishme shpirtërore. Në trashëgiminë e saj letrare është i dukshëm, deri në një masë, ndikimi i lëvizjes shpirtërore dhe letrare gjermane "Sturm und Drang" ("Stuhia dhe pasioni"), por edhe vetë mundësitë jetësore e binin shpesh deri te melankolia dhe llojit unik të vetëflijimit shpirtëror. Nga njëra anë, melankolia dha rezultatin e vetë në inspirimin e Kalorinës për shkrimin e këngëve dhe dramave, por, në anën tjetër, e sillte në kufi të

2.Krahaso, p.sh.. https://en.wikipedia.org/wiki/Karoline_von_Guenderrode (qasja në faqe, 17 prill 2018).

3.Krah. *Gesammelte Werke der Karoline von Günderrode*, fletorja 3, redaktor Leopold Hirschberg, Berlin. Verlag Goldschmidt Gabrielli, 1920-1922., reprint Bern, Herbert Lang, 1970.

4.Theksojmë që të shkruarit e ndryshëm të emrit *Mahomed* dhe *Mahomet* gjindet në vetë veprat gjermane të Karoline von Günderrode.

Ëndrra e Muhammedit në shkretëtirë e fisnikes Karoline von Günderrode

gjendjeve depressive prej të cilave nxirrej me leximet në vazhdimësi, studimit dhe meditimit.

Duhet përmendur edhe atë se Karolinës von Günderrode i dështuan dy rastet e mundshme për martesë, i pari me juristin Friedrich Carl von Savigny n, kurse i dyti me filologun dhe arkeologun me emrin Georg Friedrich Creuzer. Madje lidhja e saj me Creuzer - in përfundoi tragjikisht. Pasi prej tij pranoi letrën, që prej lidhjes së martesës nuk ka asgjë (sepse Creuzer i veç ishte i martuar), Karoline von Günderrode u shpua me thikë në bregdetin Rajne, në vendin Winkel. Kështu ajo, në moshën njëzetegjashtë vjeçare përfundoi jetën e kësaj bote dhe la veprat në hazë të cilave e kujtojnë si poete të talentuar, shkrimtare të arsimuar, autore filozofike dhe personalitet, poezia dhe proza e së cilës mbart porositë e thella të cilat na adresohen fuqishëm edhe sot.

Mes veprave të shkrimtares Karoline von Günderrode theksohen punimet “me gratë heroinë në rolin kryesor“

Padyshim është se, fisnikja dhe poetja Karoline von Günderrode me këtë dëshiroi të linte porosinë rreth shikimit të pozitës së vetë si grua në epokën e vetë. Disa vepra ajo i publikoi nën pseudonimin “Tian” i cili

është, sikurse thotë studiuesja e saj Anna C. Ezekiel, “për bashkëkohës të Günderrodine-s tingëllonte mashkullor ose i dygjimshëm” (which to Günderrode’s contemporaries sounded male or androgynous)⁵


Me këtë rast nuk kemi qëllim të flasim rreth dramës së saj (prej myslimanëve e pajustificueshme dhe padrejtësisht e neglizhuar) me titullin “Mahomed, der Prophet von Mekka”, “Muhammedi, profeti prej Mekës”, të cilën kohët e fundit Anna C. Ezekiel e përktheu në anglisht dhe me punimet e tjera e publikoi në librin me titullin “Poetic Fragments” Anna C. Ezekiel e publikoi dramën “Mahomed, der Prophet von Mekka” në origjinalin gjermanisht dhe me përkthimin paralel anglisht, faqe për faqe.⁶

Sipas burimeve, dramën “Mahomed, der Prophet von Mekka” Karoline von Günderrode e publikoi në vitin 1805 së bashku me disa vepra e veta të tjera të çmuara të cilat bashkërisht i titulloi “Poetische Fragmente” (“Fragmente poetike”). Nuk është e përjashtuar (mundësia) që këto dhe vepra tjera të saja të jenë publikuar edhe ndonjë vit përpara, në botimet e veçanta ose botime më vete.

2. Mahomets Traum in der Wüste (“Ëndrra e Muhammedit në shkretëtirë”)

Nga burimet që sjell Anna C. Ezekiel, shihet që Karoline von Günderrode famën e vetë e arriti me librin (përmbledhjen e këngëve dhe dramave historike) me titullin “Poetische Fragmente” (“Fragmentet poetike”) Rreth “Poetische Fragmente” arriti lajmi edhe deri te të famshmin Johann Wolfgang von Goethe-n (Gete, 1749-1832), i lexoi dhe ashtu dëgjoi për poeten Karoline von Günderrode dhe me lavdërim u shpreh rreth artit të saj poetik. Gjegjësisht, veprat e publikuara në përmbledhjen “Poetische Fragmente” kanë tërhequr vëmendjen e tij të konsiderueshme, shihet kjo nga një letër të cilën Goethe e shkroi dhe dërgoi në vitin 1804. Në te deklaroi që këngët/veprat prej përmbledhjes së saj “Fragmentet poetike” “me të vërtetë janë fenomen i veçantë, dukuri e veçantë”⁷

7 “The work was widely enough known to reach Goethe’s eyes, as we know from a letter he sent in 1804 stating that the poems of Poetic Fragments “are really a peculiar phenomenon.” Krahe. Goethe, letter to Eichstädt, April 28, 1804., e cituar në: Gersdorff, Erde mit Heimat, 141 Në këtë e citojmë sipas Hyrjes (Introduction) së Anne C. Ezekiel, për botimin anglisht të veprës *Poetic Fragments*, f. 3.



5. Krahaso: Karoline von Günderrode, *Poetic Fragments*, përktheu në anglisht dhe parathënieën e shkroi Anna C. Ezekiel, pub. Suny Press, State University of New York, 2016., f. 7

6. Krahaso: Karoline von Günderrode, *Poetic Fragments*, po aty

Ëndrra e Muhammedit në shkretëtirë e fisnikes Karoline von Günderrode

Ka mendime që Karoline von Günderrode me veprat e veta rreth Muhammedit, alejhiselam, dëshiroi sigurisht në mënyrën e vetë, që të kyçet në shoqërinë e Volterëve (Volterit) dhe Gothe s, të cilët pikërisht gjatë shekullit tetëmbëdhjetë kanë shkruar dhe publikuar veprat e veta (dramat) rreth profetit Muhammed a.s. Por, ato janë gjërat të cilat kalojnë në spekulime. Sido që të jetë, prej dramës së saj (historike) dramës rreth Muhammedit, si dhe prej këngës së saj “Mahomets Traum in der Wüste” (“Ëndrra e Muhammedit në shkretëtirë”) është e dukshme që Karoline von Günderrode lavdëron të dërguarin islam dhe i jep lloj të veçantë të respektit. Gjegjesisht, Karoline von Günderrode bën devijim të madh prej paraqitjeve evropiane mesjetare rreth Muhammedit a.s., të cilat shpesh ishin jashtëzakonisht fyese dhe të papranueshme për vizionet dhe ndjenjat e muslimanëve ndaj fesë së vetë. Karoline von Günderrode në shfaqjen e Muhammedit, dhe të vetë islamit, sheh fuqinë jetësore, dhe kryesisht ka “paraqitje pozitive të Muhammedit” (“... positive portrayal of Muhammad...”) ⁸ Në unitetin e Muhammedit a.s., të Arabisë fisnore Karoline von Günderrode sheh hapat të cilat i bën një paraardhës reformist i prirë për “rendin e ri botëror i cili pajton kulturat e popujve” (“a new world order that reconciles cultures and peoples...”). ⁹

Praktikisht, në sintagmën “devocioni për paqe mes kulturave dhe popujve” shihet shumë ndikimi i fuqishëm i Imanuel Kantit në veprën e poetes Karoline von Günderrode. Kanti me angazhim diskutonte rreth “paqes botërore”, si edhe shumë evropianë tjerë të famshëm të asaj kohe: Fichte, Novalis, Schlegel, Lessing...

Në fakt, nëse shikojmë këtu gjërat realisht (dhe pa “emocione tona muslimane”), plotësisht është e qartë që poetes Karoline von Günderrode peygamberi Muhammed dhe themelimi i islamit i shërbejnë si metaforë (poetike dhe filozofike) për shkrimin rreth “gjërave vendase evropiane dhe gjermane”, rreth “ringjalljes dhe transformimit të Evropës” Poetja Karoline von Günderrode në paraqitjen e Muhammedit a.s., (posaçërisht në kapërcimin dhe mbizotërimin e tij të fragmentimit politeist dhe idhujtarisë në Arabi),

sheh reformatorin, sjellësin e religjionit të ri dhe të një sinteze të freskët të përgjithshme fetare dhe kulturore. Sipas Karoline von Günderrode, është i nevojshëm ndonjë lloj religjioni të unifikuar, sipas komentimit të saj (ose, sikurse thotë Anna C. Ezekiel sipas “Muhammedit të Günderrodes”) ¹⁰ islami në të vërtetë është vetvetiu një “sintezë e judaizmit dhe krishterimit” Ja një vend prej dramës së saj historike rreth Muhammedit, në të cilën autorja Karoline von Günderrode, sigurisht në trillimin e vetë letrar, përmend fjalët e Muhammedit a.s.. Krishterimi është shkëputur prej themeluesit të vetë judaizmit, e lëshoi shtëpinë e vetë prindërore dhe devijoi në të gjitha katër anët botërore. Prej largësisë gjuan shigjetat e mbyllura të persekutimit të kokës së shenjtë të atit të vetë. Në të njëjtën kohë është në kundërshtim me vetveten, pjesët e tij diskutohen ashpër dhe trupi i tij përndryshe i ndërtuar mirë, është i mbushur me ekzeset e egra monstruoze. Ashtu është i hutuar emocioni i njerëzve, ashtu janë në mospërputhje ndjenjat dhe mendimet më të shenjta të tyre, dhe ashtu janë të pështirosur kohët dhe religjionet.

Paqja, harmonia dhe shëndeti dotë kthehet në tokë, sepse për këtë mua Zoti më dërgoi. Popujt do të mblidhen në një faltore, paganizmi dotë sakrifkohet në altarin e ri si viktimë e cila është e këndshme për Zotin, krishterimi do të kthehet pas judaizmit dhe do të pajtohet e unifikohet me të në mësimet e mia... ¹¹

Karoline von Günderrode pikërisht në këtë drejtim ka zhvilluar publikimet e veta rreth Muhammedit alejhiselam, prej manastirit të vetë në Frankfurt, ishte kureshtare në horizontet botërore dhe mendonte rreth harmonisë së njerëzimit, asaj religjioze para së gjithash. Sigurisht, kjo nuk është ideja e saj e vetme romantike, as që ishte e vetme tek romantikët e tjerë të cilët paraqiteshin në fund të shekullit XVIII dhe gjatë gjysmës së parë të shekullit XIX në të gjithë Evropën. Gjegjesisht, atëherë në shumë qarqe evropiane fuqishëm lindi ideja e “kozmpolitizmit dhe paqes botërore”

Kjo dhe ide të ngjashme ishin shtytës fillestar që në Evropën e asaj kohe rreth islamit dhe Muhammedit a.s., të imagjinohen dhe shkruhen një numër i veprave të vlefshme. S’ka dyshim që në vepra të tilla bëjnë

8. Krahe.. Anna C. Ezekiel, *Poetic Fragments*, f. 124.

9. Krahe.. Anna C. Ezekiel, *Poetic Fragments*, f. 125

10. Krahe.. Anna C. Ezekiel, *Poetic Fragments*, f. 125

11. Krahe.. Anna C. Ezekiel, *Poetic Fragments*, f. 125

Ëndrra e Muhammedit në shkretëtirë e fisnikes Karoline von Günderrode

pjesë shumë faqe të dramës historike të Karoline von Günderrode “Mahomed, der Prophet von Mekka”

“Muhammedi, profeti prej Mekës”, e në mënyrë të barabartë, madje edhe më shumë, e gjithë kënga e saj “Mahomets Traum in der Wüste” (“Ëndrra e Muhammedit në shkretëtirë”)

3.

Karoline von Günderrode murgeshë protestante?

Përmes veprave të Karoline von Günderrode s rreth të Dërguarit Muhamedit a.s., shihet pra, një shprehje e atëhershme evropiane e letërsisë romantike ose sjellje narrative. Gjegjësisht, “figurat dhe kornizat e punës prej Lindjes shpesh janë përdorë si analogji për personalitetet evropiane, ngjarjet dhe problemet.”¹² Gjithashtu, Anna C. Ezekiel përmend mundësinë që për Karoline von Günderrode profeti islam Muhammedi a.s, ishte “metaforë për Lutherin” (a metaphor for Luther)¹³ Pikërisht, ajo në disa vende në veprat e veta rreth Muhammedit a.s., në mënyrë prekëse sjell, sigurisht, duke u adresuar me imagjinatën e vetë letrare, si Muhammedi bind pasuesit e vetë në Meke me këto fjalë: “Darum hat er mich zu euch gesandt, daß ich euch berufen soll in seinem Namen, und euch, die ihr verschmachtet in der dürren Wüste der Zeitlichkeit, tränke mit dem frischen Brunnquell des ewigen Lebens.”¹⁴

“Për atë ai [Zoti] më dërgoi drejt jush, që t’ju thirri në emrin e tij, dhe juve që veniteni në shkretëtirën e thatë të kalueshmërisë, t’ju shuaj etjen me burimin e freskët të jetës së amshueshme.” A e orientuan në këtë adresim të Karoline von Günderrode për Muhammedin a.s., si figurë letrare, por edhe si “metaforë për paraqitjen e Lutherit” (i cili, kinse, do ta ringjallë Evropën me ujërat e pijshme dhe të freskëta të reformave të veta!), një autore tjetër, Minou Reeves, që në librin e vetë “Muhammad in Europe” (Muhammedi në Evropë) të pohojë se si Karoline von Günderrode ishte murgeshë (protestante)? Kjo është pyetje për të cilën ne nuk mund të japim përgjigje të besueshme.

Pikërisht, Minou Reeves në veprën e vetë

“Muhammedi në Evropë” pretendon që kënga e Goethe-s “Mahomets Gesang” është e shkruar qysh në vitin 1772, “rreth 20 vite para sukseseve të Napoleonit dhe gati 60 vjet para se të jenë botuar teoritë e Hegelit rreth rolit të personaliteteve historike botërore. Goethe e lavdëronte Muhammedin si njeri të veçantë i cili në Kuranin e vetë la trashëgiminë e cila do të zgjasë plot një përjetshmëri”¹⁵

Minou Reeves pretendon edhe se “Goethe nuk ishte i vetmuar në njohjen e elementeve të gjenialitetit tek Muhammedi. Në vitet e hershme të shekullit 19, edhe një simpatizues i madh i Napoleonit, Karolina fon Günderrode (Karoline von Günderrode), shkroi copë drame dhe poeme, duke e prezantuar Muhammedin si personalitet të jashtëzakonshëm të proporcioneve kolosale.”¹⁶

Minou Reeves veçanërisht flet rreth poemës së Karoline von Günderrode rreth Muhammedit a.s., dhe thotë si vijon.

“Poema e saj me titullin Mahomets Traum in der Wüste (“Ëndrra e Muhammedit në shkretëtirë”), është e publikuar në vitin 1804. Günderrode ishte motër nderi e cila gjithë jetën e kaloi e izoluar prej jetës së zakonshme. Por kjo nuk e izoloi edhe prej adhurimit të heroit i cili nisi prej lëvizjes gjermane Sturm und Drang e viteve 1770 dhe u bë karakteristikë kryesore të ndjeshmërisë së shekullit 19 Si edhe tek shumë të tjerë, admirimin e saj e inkurajoi Napoleoni, kështu që Günderrode, madje prej manastirit femëror gjerman, shikonte figurën e tij të largët me adhurim. Në veprën Mahomets Traum in der Wüste, (“Ëndrra e Muhammedit në shkretëtirë”), Muhammedi është figurë napoleoniane, ambicia e madhe e të cilit është që ta fitojë botën dhe të ndryshojë ligjet e saja ekzistuese t’i idealizojë.”¹⁷

Më në fund, Minou Reeves përfundon.

“Kjo është poemë e fuqishme e cila ndërlihd imazhet e përjetimeve të Muhammedit të shpalljes hyjnore në shkretëtirë me aspekte të lutjes së Jezusit në Kopshtin e Getsemanit, para kryqëzimit, dhe me konceptet

12. “Characters and settings from the East were also often used as analogies for European figures, events, and problems” Sipas: Anna C. Ezekiel, *Poetic Fragments*, f. 123

13. Krah. Anna C. Ezekiel, *Poetic Fragments*, f. 123

14. E cituar sipas burimit origjinal gjerman drama e Günderrode-s rreth Muhammedit, a.s., të cilin e sjell Anna C. Ezekiel, *Poetic Fragments*, f. 183

15. Krah. Minou Reeves, *Muhammad in Europe*, New York University Press, 2003., f.182.

16. Minou Reeves, po aty, f. 183

17. Minou Reeves, po aty, f. 183

Ëndrra e Muhammedit në shkretëtirë e fisnikes Karoline von Günderrode



e religjionit antik persian Zaratusrës përkatësisht Zoroastrës, përmes përshkrimit të katër elementeve: tokës, ujit, ajrit dhe zjarrit. Muhammed, seher, përkatësisht vizionar, vuan në drithërimën që t'i njohë fshehtësitë e jetës dhe të ardhmes së vetë.

Ai dëshiron të meditojë, të dëgjojë zemrën e vetë dhe ta thërras shpirtin e Krijuesit për të cilin beson se është në te. Por, sa më shumë shikon, sa më shumë dëgjon, me këtë më shumë mundimi i tij dhe avaria përfundimtare - untergangu i tij bëhen më të dukshëm. Ëndrra e tij së shpejti shndërrohet në makth.

Para syve të tij zhvillohet bota e kaosit dhe mallkimit. Aktiviteti i tij prishi harmoninë e elementeve. Ata bëhen të egër dhe të dhunshëm. Toka fillon të dridhet, Dielli sillet përmbytshëm dhe flakët e tërbuara të zjarrit gëlltisnin shkëmbinj dhe shkrep, duke shkatërruar gjithçka që është e krijuar në tokë, duke mos lënë asgjë përveç erës së ashpër të squfurit në ajër. Thellë i trishtuar, Muhammedi zgjohet i mbushur me ndjenjën e hutimit dhe tmerrit. Sikur të jetë zgjuar prej dhimbjes së tmerrshme, vdekjes së pa perëndishme, por menjëherë dëgjon zërin i cili lëshohet nga yjet.

Ai është zëri i Krijuesit i cili paralajmëron se Muhammedi me të vërtetë ka trazuar historinë botërore, duke pretenduar që të depërtojë në hapësirën e të vërtetës hyjnore. Atë çfarë pa, konfirmoi Zoti, ishte historia njerëzore në zhdukje. Lufta e elementeve nisi shiun e pandërprerë, i cili duhej të pastrojë tokën prej çdo papastërtie të saj, duke mos lënë asgjë pas vetes, përveç dritës. Ajo dritë do të mbetet përgjithmonë, dhe dritës ndaj burimit të vetë të përhershëm. Pastaj errësirën e natës e zëvendësuan valët e dritës verbuese të agimit të cilët vërshuan shpirtin e Muhammedit.”¹⁸

Në fund, të themi se ky trajtim letrar i të Dërguarit të Zotit Muhammedit a.s., nga ana e Karoline von Günderrode, asaj fisnikes dhe poetes tragjike, është shumë domethënëse edhe për ne në Bosnje dhe Hercegovinë. Komentimet, vegimet dhe pritjet ndryshohen gjatë kohëve, por mbetet përgjithmonë ajo magjepsje e këndshme ndaj njerëzve të mëdhenj të njerëzimit, posaçërisht nëse janë të përzgjedhur prej Zotit si të dërguar dhe lajmëtarë të Zotit.

*Nga gjuha boshnjake përktheu:
Azmir & Behrim JUSUFI, Prizren*

18. Minou Reeves, po aty, f. 183-184.